

URDHËR
Nr.92, datë 28.9.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI HARMONIZIMIN E KËRKESAVE TEKNIKE
DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët evropiane të aviacionit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e aviacionit civil”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Dispozitat e kësaj rregulloreje kanë përparësi mbi dispozitat me të njëjtin objekt të trajtuar në urdhrat dhe udhëzimet e mëparshme.
 3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi